



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 44

Datë: 21. 08. 2024 ora: 10:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Ilir Gashi, Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Alban Krasniqi, Sami Hamiti, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Fazli Stollaj, Qemailj Kurtis, Mufera Shinik.

Burim Ahmetaj, krye shef i SKQZ. Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së**
- 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit Nr.40 dhe 41 dhe 42 /2024**
- 3. Aktivitetet e Zyrës:**

-Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për kufizimin e shpenzimeve të fushatës së zgjedhjeve për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, datë 09.02.2025.

- 4. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores Zgjedhore Nr.15/2024 për Zgjedhjet e Parakohshme dhe të Jashtëzakonshme;**

5. Raport i Këshillave të KQZ

5.1.Këshilli për Operacione Zgjedhore

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Aktiviteteve Zgjedhore, për zgjedhjet e rregullta për Kuvendin e Kosovës;**

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Themelimit të Komisionit për shqyrtimin e kundërshtimit administrativ të parashtruar kundër njoftimit për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës, për zgjedhjet e rregullta për Kuvendin e Kosovës;

5.2. Këshilli për Çështje Ligjore

1. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësim të anëtari të kuvendit komunal në Kaçanik;

5.3. Këshilli për Personel

6. Të ndryshme

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Kreshnik Radoniqi, kryesues i mbledhjes, paraqiti rendin e ditës së takimit.

Me 11 vota për, u miratua agjenda e takimit.

Sami Kurteshi, tha se në mbledhjen 41 mungon emri im, si pjesëmarrës. Të shtohen emri im...

Me 11 vota për miratohen procesverbalet: 40, 41 dhe 42 /2024.

2. Aktivitetet e Zyrës:

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për kufizimin e shpenzimeve të fushatës së zgjedhjeve për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, datë 09.02.2025:

Besnik Buzhala: E keni bashkangjitur rekomandimin ! Siç dihet, KQZ jo më vonë se 5 ditë pas shpalljes së zgjedhjeve merrë vendim për kufizimin e shpenzimeve të fushatës. Dje, më 20 gusht, Zyra ka një raport të numrit të përgjithshëm të votuesve: **2, 47149** votues. Kufizimi, është jo më pak se 1 euro për votues. Është vlera minimale....Zyra rekomandon për aprovim.

Me 11 vota për, miratohet ky rekomandim i Zyrës.

Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores Zgjedhore Nr.15/2024 për Zgjedhjet e Parakohshme dhe të Jashtëzakonshme:

Kreshnik Radoniqi: E kemi pasur, e kemi draftu. A ka dikush diçka lidhur me këtë rregullore ? Nëse jo, kush është për miratim ? Është rregullorja e fundit që po e miratojmë...!

Me 11 për, miratohet Rregullorja Zgjedhore Nr.15/2024 për Zgjedhjet e Parakohshme dhe të Jashtëzakonshme.

3. Raport i Këshillave të KQZ

5.1.Këshilli për Operacione Zgjedhore:

1.Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Aktiviteteve Zgjedhore, për zgjedhjet e rregullta për Kuvendin e Kosovës:

Arianit Elshani, tha se KOZ e ka shqyrtuar planin e aktiviteteve. Ky plan, është konform rregulloreve, ligjit për zgjedhjet dhe konsiderojmë që është një plan që parasheh të gjitha aktivitetet.

Z. Elshani, lexoi para anëtarëve të gjitha aktivitetet e procesit zgjedhor. Pastaj, ai kërkoi miratimin e këtyre aktiviteteve.

Diskutuan: Alban Krasniqi.

Me 11 vota për, u miratua plani i aktiviteteve zgjedhore.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Themelimit të Komisionit për shqyrtimin e kundërshtimit administrativ të parashtruar kundër njoftimit për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës, për zgjedhjet e rregullta për Kuvendin e Kosovës:

Arianit Elshani: Gjithashtu, KOZ e ka shqyrtuar edhe formimin e komisionit për shqyrtimin e kundërshtimit administrativ të parashtruar kundër njoftimit për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës, për zgjedhjet e rregullta për Kuvendin e Kosovës. Mandati i këtij komisioni, nga themelimi, përfundon me përfundimin e afatit për shqyrtimin e ankesave. Përbërja është: Emira Alushi, Lirik Krasniqi dhe Premtim Rustemi.

Me 11 vota për, miratohet rekomandimi për formimin e këtij komisioni.

4. Këshilli për Çështje Ligjore

2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësim të anëtari të kuvendit komunal në Kaçanik:

Sami Hamiti, tha se në mbledhjen e këshillit, është shqyrtuar kërkesa për zëvendësimin e një anëtari të kuvendit komunal në Kaçanik. Kemi sugjerua për zëvendësim, meqë janë plotësua të gjitha kushtet që

Edona Lusha, të emërohet anëtare e re e kuvendit komunal në Kaçanik nga subjekti politik AAK, duke e zëvendësuar anëtarin e deritashme Rabije Sallahu.

Me 11 vota për, miratohet ky zëvendësim.

5. Këshilli për Personel

Alban Krasniqi, tha se me gjithë ndryshimet dhe angazhimet nuk e kemi një listë të gjithë stafit për angazhim. Kemi kërkuar që të kemi një agjendë emergjente në këta dy muaj që, ta një ngritje të aktivitetit në procese. Ju, e keni një raport. Janë 12 pozita. Gjithsej: 25 të angazhuar – rekrutime për 12 pozita.

Z. Krasniqi, i pasqyroj kërkesat sipas departamenteve dhe në QNR. Ky, është grupi i parë i rekrutimeve...

Diskutuan: **Ilir Gashi**, kërkoi që edhe për anëtarë të KQZ-së të ketë personel të përkohshëm. **Gordana Llaban**, kërkoi që në serbisht të kihet parasysh rekrutimi sepse, tani e kemi vetëm një person që përkthen. Po ashtu, diskutoi edhe Arianit Elshani, Alban Krasniqi.

Me 11 vota për miratohet lista e rekrutimeve të stafit të përkohshëm.

Alban Krasniqi, e informoi KQZ-në se rregullorja për shfrytëzimin e automjeteve është miratu.

Kreshnik Radoniqi, tha se për shkak të kohës po e paraqes këtë informacion nga Këshilli Për Marrëdhënie me Jashtë. E kemi një ftesë nga IFES për të marrë ftesë në një simpozium me temën debatuese: “Dezinformimi, koordinimi, mësimet e zëna nga zgjedhjet e mbajtur evropiane 2024...!”. Kjo mbahet me 13 shtator, në Pragë. Shpenzimet, i bartim ne. Nëse kemi interesim...?

Simpoziumi është njëditorë. Ne, megjithatë do të kërkojmë që një pjesë të shpenzimeve të na mbulohen, tha z. Radoniqi.

U propozua që, Alban Krasniqi të marrë pjesë...

6. Të ndryshme!